

# UDHËZUES MBI PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE (PMP)

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë.

Ky Udhëzues duhet të përdoret si një ndihmë për të kuptuar përdorimin e drejtë të pajisjeve mbrojtëse personale (PMP).



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,*

*Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
ÇKA JANË PMP-të?.....	2
ÇKA DUHET TË DINI PËR PMP-të?.....	3
ZGJEDHJA E DUHUR E PMP-ve.....	4
RREZIQET DHE LLOJET E PMP-ve .....	5
TRAJNIMI PËR PËRDORIMIN E DUHUR TË PMP-ve .....	7
KONTROLLIMI DHE MIRËMBAJTJA E PMP-ve .....	8
AUDITIMET .....	9
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	9
SHTOJCA .....	10




## HYRJE

Si punëdhënës dhe si pjesë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë brenda biznesit tuaj, ju jeni përgjegjës për të mbrojtur punëtorët tuaj nga dëmtimet gjatë punës. Si pjesë e kësaj përgjegjësie, do t'ju kërkohet t'u siguron punëtorëve tuaj, pa pagesë, pajisjet e duhura mbrojtëse personale (PMP) sipas RREGULLORES (MPMS) Nr. 02/2016. Vlerësimi i riskut do të identifikojë kontrollet për mbrojtjen e punëtorëve tuaj dhe të tjerëve.

Para se të zgjidhni PMP-të, si punëdhënës, duhet të kryeni një vlerësim të rrezikut në përputhje nenin 5 të rregullores së mësipërme, , i cili përfshin pikat kryesore në vijim:

- Identifikimin e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohen të punësuarit dhe personat e vetëpunësuar.
- Analizimin e rreziqeve për të identifikuar se cilat rreziqe mund të shmangen duke përdorur mjete të tjera përveç PMP-ve.
- Të siguroheni që PMP-të të jenë efektive në lidhje me rreziqet e identifikuara dhe që ato të mos paraqesin rreziqe të mëtejshme që lidhen me përdorimin e tyre.

Hierarkia e kontrolleve të rrezikut përcakton që Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP) duhet të përdoren si mjet i fundit në mbrojtjen e punëtorëve. Kudo që ka rreziqe për shëndetin dhe sigurinë, të cilat nuk mund të kontrollohen në mënyrë adekuate me mjete të tjera, ju duhet të identifikoni dhe të siguron për punëtorët të cilëve ju duhen të përdorin PMP-të, të cilat janë adekuate dhe të përshtatshme për qëllimin për të cilat do të përdoren.



Kërkesa ligjore e cila kërkon përdorimin e PMP -ve rrjedh nga LIGJI NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË. Sipas neneve 13 dhe 14 të këtij ligji specifikohen kërkesat për PMP-të. Për më tepër, RREGULLORJA (MPMS) Nr. 02/2016 paraqet në hollësi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale në vendin e punës.



## ÇKA JANË PMP-të?

PMP-të janë pajisje që do të mbrojnë përdoruesin nga rreziqet e shëndetit ose sigurisë në punë. Mund të përfshijnë artikuj të tillë si helmata sigurie dhe kapele të forta, doreza, mbrojtje për sytë, veshje me retro-reflektues, këpucë sigurie dhe pajisje sigurie.



**Artikujt e mëposhtëm nuk klasifikohen si PMP sipas RREGULLORES së MPMS-së Nr. 02/2016:**

- Veshjet që nuk janë krijuar posaçërisht për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve dhe personave të vetëpunësuar.
- Pajisjet mbrojtëse personale të veshura ose të përdorura nga ushtria, policia e shtetit dhe shërbimet e emergjencës civile.
- Pajisjet sportive.
- Pajisje mbrojtëse dhe parandaluese për vetëmbrojtje.
- Pajisjet, përfshirë edhe pajisjet mobile për zbulimin dhe sinjalizimin e rreziqeve.



## ÇKA DUHET TË DINI PËR PMP-të?

Të gjithë të punësuarit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të përdorin PMP-të. PMP-të e tilla duhet të përdoret në çdo kohë në përputhje me udhëzimet e prodhuesve dhe në përputhje me kontrollet e përcaktuara në vlerësimin e rrezikut të përgatitur nga punëdhënësi.

**Pikat kyçe të mëposhtme duhet gjithashtu të merren në konsideratë dhe të vendosen kontrollet e duhura të menaxhimit për të siguruar që:**

- Të gjitha PMP-të vlerësohen para përdorimit për t'u siguruar që janë të përshtatshme për qëllimin për të cilin do të përdoren.
- Të gjitha PMP-të mirëmbahen dhe ruhen në mënyrë të përshtatshme.
- Punëtorëve u ofrohen udhëzime dhe trajnim në lidhje me përdorimin e PMP-ve.
- Kontrolloni që PMP-të janë duke funksionuar dhe se janë duke u përdorur në mënyrë të duhur nga punëtorët.

Në mënyrë që të mos ndodhin dëmtime aksidentale, përdorimi i PMP-ve është qenësor dhe duhet të jetë një çështje kryesore në punë. Rregulloret e PMP-ve ndihmojnë për të treguar se si vendet e punës dhe punëtorët duhet të përdorin pajisjet mbrojtëse dhe tregojnë që ato paraqesin të paktën absolute që vendet e punës duhet të bëjnë për të mbrojtur punëtorët e tyre.

Kjo do të thotë që përdorimi i PMP-ve duhet të jetë pjesë e një plani më të gjerë për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Edhe në vendet ku aplikohen kontrolle të tjera dhe sisteme të sigurta të punës, disa rreziqe përsëri mund të mbesin. Këto përfshijnë dëmtime të:

- Mushkërive, p.sh. nga frymëmarrja në ajër të ndotur
- Kokës dhe këmbëve, p.sh. nga materiali që bie
- Syve, p.sh. nga grimcat fluturuese ose spërkatjet e lëngjeve gërryese
- Lëkurës, p.sh. nga kontakti me materiale gërryese
- Trupit, p.sh. nga temperaturat tepër të larta të nxehtësisë ose nga të ftohtit ekstrem.



**Në raste të tilla përdorimi i PMP-ve është plotësisht i nevojshëm dhe mund të luajë një rol të mtejshëm në zvogëlimin e rrezikut.**



## ZGJEDHJA E DUHUR E PMP-ve

Para se të zgjedhim llojin dhe natyrën e PMP-së që kërkohet për të mbrojtur punëtorët, duhet të parashtroni pyetjet në vijim:

1. A e mbrojnë PMP-të bartësin nga rreziqet dhe a janë në pajtim me kushtet mjedisore ku po kryhet detyra?
2. A e rrit përdorimi i PMP-ve nivelin e përgjithshëm të rrezikut ose shton rreziqe të reja?
3. A mund të përshtatet për nevoja individuale të përdoruesit?
4. Cilat janë nevojat e punës dhe kërkesat e paraqitura për personin që i përdor?
5. Nëse dikush mban më shumë se një artikull të PMP, a janë ata në përputhje me njeri tjetrin?
6. Konsultohuni me fuqinë punëtore sa herë zgjedhni një PMP.

**Çfarë duhet të merrni parasysh kur zgjedhni PMP-të e duhura:**

- ✓ Gjithmonë zgjedhni produkte me cilësi të mirë, të cilat janë të shënuara me markën CE ose ekuivalente
- ✓ Zgjidhni pajisje që i përshtaten përdoruesit - merrni parasysh madhësinë, përshtatjen dhe peshën
- ✓ Merrni parasysh shëndetin e punëtorit, p.sh. nëse pajisjet janë shumë të rënda, ose punëtorët kanë çështje specifike shëndetësore, atëherë PMP-të standarde mund të mos jenë e përshtatshme
- ✓ Lëri përdoruesit të ndihmojnë në zgjedhjen e PMP-ve së tyre, sepse ka shumë më të ngjarë që t'i përdorin ato nëse i zgjedhin vetë.
- ✓ Merrni parasysh gjininë kur zgjidhni PMP-të.

Për t'u siguruar që është zgjedhur lloji i duhur i PMP-ve, merrni parasysh rreziqet e ndryshme në vendin e punës dhe identifikoni PMP-të që do të sigurojnë mbrojtje adekuate ndaj tyre; kjo mund të jetë e ndryshme për secilën punë. Kërkoni nga furnitori juaj t'ju ofrojë këshilla në lidhje me llojet e PMP-ve që ka në dispozicion dhe përshtatshmërinë e tyre për detyra të ndryshme. Në disa raste, mund t'ju duhet të merrni këshilla nga specialistë ose nga vetë prodhuesi i PMP-ve.

**Shpërndarja dhe përdorimi i PMP-ve për fuqinë tuaj punëtore:**

- ✓ Gjithmonë udhëzoni dhe trajtoni punëtorët se si të përdorin ose veshin PMP-të e tyre
- ✓ Gjithmonë u tregoni punëtorëve pse PMP-ja është e nevojshme, kur ta përdorin atë dhe cilat janë kufizimet
- ✓ Asnjëherë mos lejoni që punëtorët të heqin PMP-në e tyre për ato punë që "marrin vetëm disa minuta"
- ✓ Kur, ose, nëse diçka ndryshon në punë, kontrolloni që PMP-ja e dhëna është akoma e përshtatshme dhe, nëse është e nevojshme, bëni ndryshime.





## RREZIQET DHE LLOJET E PMP-ve

PMP-të mund të përfshijë artikuj të tillë si helmetat e sigurisë, dorezat, mbrojtja e syve, kostumet hazmat, veshjet retro-reflektuese, këpucë sigurie, pajisje sigurie, tamponë për veshë, mbrojtëse për veshë dhe pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes (PMF). Në situata të përshtatshme mund të sigurohen PMP-të për një përdorim p.sh. kominoshe për një përdorim. Punëdhënësit e kanë për detyrë sigurimin dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale në punë.

### PMP-të nuk përfshinë:

- Rrobat ose uniformat e zakonshme të punës që nuk janë krijuar për të siguruar shëndetin ose sigurinë e punëtorëve.
- Veshjet e siguruara për qëllime të higjienës ushqimore.
- Pajisjet e përdorura për mbrojtje gjatë udhëtimit në rrugë publike (p.sh. helmetat për motoçikleta ose biçikleta).
- Pajisjet e përdorura gjatë garave sportive (por pajisjet e tjera mbrojtëse të përdorura nga instruktorët e sporteve do të përfshiheshin p.sh. xhakëtë shpëtimi të veshur nga instruktori i kanoes).
- Një armë sulmuese e përdorur si vetëmbrojtje ose si pajisje parandaluese. Për shembull, shkopinj dore ose bombola gazi CS siç përdoren nga policia ose ushtria (por përfshihen helmetat, jelekët mbrojtës dhe PMP të tjera të përdorura për të mbrojtur stafin nga dhuna fizike).
- Pajisjet portative për zbulimin dhe sinjalizimin e rreziqeve dhe shqetësimeve, të tilla si shenjat për zbulimin e rrezatimit, ose detektorë personalë të gazit.

Në hierarkinë e kontrollit të rrezikut, konsiderohet që PMP-të renditet më e ulëta dhe paraqiten në opsionin e fundit. Një nga arsytet që PMP-të konsiderohen në këtë mënyrë është se PMP-ja mbron vetëm punëtorin që e përdor atë, ndërsa masat që kontrollojnë rrezikun në burim mund të mbrojnë të gjithë në vendin e punës.





Cilat pjesë të trupit duhet të mbrojmë nga cilat rreziqe?

## 1 KOKA

**Rreziqet:** Goditja nga rënia ose fluturimi i objekteve, rreziku i goditjes së kokës në sende statike, rreziku i ngatërimit të flokëve.

**Opsionet:** Ekzistojnë një varg helmetash, kapele të forta dhe kaska.

## 2 SYTË

**Rreziqet:** Ndikimi i predhave të ndryshme, pluhuri, spërkatjet kimike ose spërkatjet e metaleve të shkrirë, gazi, avujt dhe rrezatimi.

**Opsionet:** Syze sigurie, syze, mburoja të fytyrës, maska.

## 3 MUSHKËRITË

**Rreziqet:** Ambienti me pluhur, avull, gaz, mungesë oksigjeni.

**Opsionet:** Filtra për një përdorim për fytyrë apo respirator, respirator që mbulon gjysmë apo tërë fytyrën, helmet me furnizim me ajër, aparate për frymëmarrje (AF).

## 4 DUART DHE KRAHËT

**Rreziqet:** Gërvishtje, ekstreme të temperaturës, prerje dhe shpim, mavijosje për shkak të goditjes, djegie kimike, goditje elektrike, infeksione të lëkurës, sëmundje ose ndotje të tjera.

**Opsionet:** Dorëza të ndryshme mbrojtëse, mbrojtëse krahësh.

## SHPUTAT & KËMBËT

## 5

**Rreziqet:** Rrëshqitje, prerje dhe shpim, goditja nga objektet që bien, metale të shkrira ose derdhje kimike, gërvishtje.

**Opsionet:** Çizme sigurie dhe/ose këpucë me mbrojtëse nga goditjet dhe shpimi, çizme të gjata, mbrojtëse këmbësh, mbrojtëse të njëjës së këmbës.





# TRAJNIMI PËR PËRDORIMIN E DUHUR TË PMP-ve

## Si PUNËDHËNËS duhet të:

- Kuptoni përgjegjësitë tuaja dhe ndërmerrni hapa për të mbajtur të sigurt punëtorët tuaj dhe qytetarët.
- Dini çfarë PMP duhet të siguroni dhe çfarë trajnimi duhet t'u ofroni punëtorëve për t'u siguruar që ata i përdorin ato në mënyrë të duhur.

## Si PUNËTORË duhet të:

- Kuptoni përgjegjësitë tuaja për përdorimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e PMP tuaja.

Kur sigurohen PMP-të, kërkohet që të gjithë punëtorët të informohen siç duhen, udhëzimet dhe trajnimin për përdorimin e tyre dhe të tregojnë se si duhet të mirëmbahen, pastrohen dhe asgjësohen pajisjet. Se çfarë informacione, udhëzime dhe trajnime nevojiten varet nga ndërlikimi dhe qëllimi i pajisjes, për shembull, për një pajisje të plotë të aparatit të frymëmarrjes do të nevojitet më shumë trajnim për përdorimin e saj se sa mund të duhet për një maskë njëpërdorimëshe të fytyrës.

Përveç trajnimit fillestar, trajnimi i rifreskimit mund të jetë i nevojshëm herë pas here. Kontrollat e mbikëqyrësit mbi përdorimin e PMP-ve mund të ndihmojnë në përcaktimin se kur nevojitet trajnim rifreskues. Përdorni informacionin e prodhuesve për PMP-të kur përpiloni dhe jepni trajnime.

## Çfarë duhet të mbulojnë informacioni dhe udhëzimet për PMP-të?

- Rreziqet e pranishme dhe pse janë PMP-të të nevojshme
- Operimi (përfshirë një demonstrim), performanca dhe kufizimet e pajisjeve
- Përdorimi dhe ruajtja (përfshirë mënyrën e vendosjes, rregullimit dhe heqjes)
- Çdo kërkesë testimi para përdorimit
- Çdo mirëmbajtje që mund të kryhet (p.sh. masat e higjienës për përdorimin e PMP-ve një ose më shumë herë)
- Faktorët që mund të ndikojnë në performancën e pajisjeve (p.sh. kushtet e punës, faktorët personal, defektet dhe dëmtimet)
- Si të njohim defektet në PMP-të dhe si të bëhet raportimi i tyre
- Ku mund të merrni PMP-të zëvendësuese.





## KONTROLLIMI DHE MIRËMBAJTJA E PMP-ve

PMP-të mund të humbasin efektivitetin e tyre ose të dëmtohen për shkak të ekspozimit ndaj zhavorrit, papastërtive, kimikateve, rrezeve UV, keqpërdorimit ose mund vjetrohen. Kjo është arsyeja pse inspektimet e rregullta janë thelbësore për t'u siguruar që PMP janë të përshtatshme për qëllimin e tyre, në kohë dhe të duhura.

Në rast se një PMP nuk përdoret, ajo duhet të mbahet në temperaturë dhome larg lagështirës, rrezeve UV dhe kimikateve. Këta faktorë - së bashku me papastërtitë, ndotjet, dëmtimet nga përdorimi i vazhdueshëm – e përshpejtojnë procesin e vjetërimit të PMP-së. Inspektimi dhe mirëmbajtja do t'ju ndihmojë të zgjasni jetën e pajisjeve tuaja të sigurisë dhe në asnjë rrethanë nuk duhet që ato të merren si të mirëqena. Përmbajuni certifikatave/ udhëzimeve të prodhuesve për të kontrolluar pajtueshmërinë, kushtet dhe skadimin e PMP-së, nëse ka të tilla.

Lista e kontrollit e paraqitur më poshtë është një shembull i cili mund të përdoret nga punëtorët për të inkurajuar një kontroll javor ose periodik të të gjitha PMP-ve të tyre.

Lista e kontrollit e punëtorëve për pajisjet personale mbrojtëse				
Emri i punëtorit		Pozita në punë		Kontrolli javor i PMP-së - Data
Kategoria e PMP-së	Tipi	Gjendja	Të zëvendësohet	Inicialet e punëtorit
		Dobët/E pranueshme/E mirë	Po/Jo	
Mbrojtja e duarve – dorëzat				
Mbrojtja e kokës				
Mbrojtja e syve				
Veshja retro - reflektuese				
Mbathje mbrojtëse				
Mbrojtja e dëgjimit				
Tjetër 1				
Tjetër 2				
Tjetër 3				
Tjetër 4				
Tjetër 5				
Dorëzoheni këtë formë te mbikëqyrësi juaj në baza javore				



## AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

## VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**Mbani mend:** Keni obligim ligjor që t'u siguron punëtorëve tuaj pajisje të duhura mbrojtëse personale në punë. Mund t'i mbron punëtorët nga dëmtimi duke kryer një vlerësim të rrezikut, duke zgjedhur PMP-në e duhur, duke siguruar trajnim për përdorimin e saktë të PMP-ve dhe duke kontrolluar dhe mirëmbajtur PMP-të, duke u siguruar që është e përshtatshme për qëllimin për të cilin është krijuar.

**Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.**



## SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për “Pajisjet Mbrojtëse Personale” (Udhëzuesi), siç janë marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së i zhvilluar në mars të vitit 2021, janë dhënë më poshtë:

Seksionet referuese:

### 3.1. Pajisje mbrojtëse personale në vendin e punës

1. A veshin PMP të gjithë personat në punishte/vend të punës?
2. A i përdorin punëtorët PMP-të sipas udhëzimeve tuaja?
3. A ofrohen PMP falas nga ju?
4. A japin PMP-të mbrojtje efektive ndaj rreziqeve/kushteve ekzistuese dhe nuk rrisin rreziqe të tjera?
5. A mirëmbahen PMP-të (p.sh. nuk janë prishur, nuk janë riparuar me metoda të papërshtatshme, nuk janë të ndyra deri në ekstrem)?
6. A janë PMP-të e rehatshme për punëtorët, në përputhje me PMP-të e tjera, të rregulluara në mënyrë të përshtatshme (p.sh. përkrenare, parzmore sigurie) sa i përket madhësisë (nëse ajo rregullohet) ose përputhen me madhësinë e duhur?
7. A plotësohen kërkesat higjienike nëse disa persona përdorin të njëjtat PMP?
8. A janë punëtorët të informuar/trajnuar pse duhet të përdorin PMP-të?
9. A janë të shënuara PMP-të me shenjën CE?
10. A keni vlerësuar nëse rreziqet mund të shmangen ose zvogëlohen mjaftueshëm me mjete teknike të mbrojtjes kolektive ose me masa, metoda ose procedura të organizatave të punës?
11. A zgjidhen PMP-të bazuar në vlerësimin e rrezikut në vendin e punës?
12. A ekzistojnë katalogë të azhurnuar të pajisjeve mbrojtëse personale për secilin profesion?
13. A ekzistojnë rregulla të përgjithshme të azhurnuara për përdorimin e PMP-ve?
14. A keni përfshirë punëtorët ose përfaqësuesit e tyre në përzgjedhjen, sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e PMP-ve?
15. A janë në dispozicion dokumentet e PMP-ve që jepen nga prodhuesi?